



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

VENDIM

Nr. 1 datë 28.1.2021

**PËR MIRATIMIN E KRITEREVE PËR DHËNIEN E NDIHMËS
EKONOMIKE PËR FAMILJET APLIKUESE, TË CILAT NUK JANË
SHPALLUR PËRFITUESE NGA SISTEMI I PIKËZIMIT DHE QË DO TË
TRAJTOHEN NGA FONDI SHITESË MBI FONDIN E KUSHTËZUAR (6%)
PËR NDIHMËN EKONOMIKE.**

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 28.1.2021, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të ligjit Nr. 139/2015, "Për vetqeverisjen vendore", neni 21 të Ligjit Nr. 57/2019 "Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë", Aktit Normativ nr.3, datë 15.03.2020 "Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19" VKM nr. 597 datë 04.09.2019 "Përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike", kreu IV, pika 1, si dhe bazuar në relacionin e përgatitur nga administrata e Bashkisë Shkodër, me 28 vota Pro,

V E N D O S I:

1. Miratimin e kriterëve për përzgjedhjen e familjeve në nevoje që do të trajtohen me fondin shtesë mbi fondin e kushtëzuar (6%) për ndihmën ekonomike, sipas tabelës bashkëlidhur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar.

Sekretar i Këshillit

Denis Lesha



KRYETARE

Brisela KADIJA

KRITERET PËR DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE PËR FAMILJET QË DO TË TRAJTOHEN NGA FONDI SHITESË MBI FONDIN E KUSHTËZUAR (6%).

Nr.	KRITERET E PIKËZIMIT	PIKËT (Total 100)	DOKUMENT KONFIRMUES
1	Familje një prindërore me një ose më shumë femijë nën moshë pune	19	Çertifikatë familjare, vërtetim shkolle
2	Familje me 3 apo më shumë femijë nën moshë pune	17	Çertifikatë familjare, vërtetim shkolle
3	Familje me 1-2 anëtarë me moshë mbi 50 vjeç secili (pa të ardhura)	15	Çertifikatë familjare
4	Familjet që kanë në përbërje persona me aftësi të kufizuara apo invalid pune.	13	Çertifikatë familjare, kopje vendimi nga Kom.mjeko- ligjor
5	Familje të ngujuara për gjakmarrje	11	Çertifikatë familjare, vërtetim nga Dr. Raj. e Policisë së Shtetit
6	Familje që kanë k/familjarin në burg apo për kurim brenda vendit	9	Çertifikatë familjare, vërtetim nga institucioni vuajtjes së denimit/ose kom. mjeko-ligjor
7	Familje në proces divorci	7	Çertifikatë familjare, vërtetim nga Gjykata
8	Familje që kanë anëtar madhor të humbur apo zhdukur dhe si të tillë nuk mund të paraqiten tek administratori çdo tre muaj për deklaram	5	Çertifikatë familjare, vendim/vërtetim nga Gjykata
9	Familje të prekura nga fatkeqësite natyrore	3	Çertifikatë familjare, konfirmim nga sektori i emergjencave civile pranë bashkisë
10	Çdo kategori tjetër familje në nevojë e cila nuk mund të plotësojë nevojat bazë jetike	1	Çertifikatë familjare

